



**BASHKIA KORÇË  
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE**

**R E L A C I O N**

**PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE  
“PANARIT-TRESKË”, “PËRPARIMAJ-DARDHË”, “VOSKOPOJË”,  
“VOSKOPOJË2”, “ZËMBLAK – QARR” DHE EKONOMISË KULLOSORE  
“RUNGAJË”.**

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, nenit 27, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 115 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kulloso”, të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar, gjatë marrjes në dorëzim dhe vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kulloso që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë është konstatuar se planet e mbarështimit rezultonin të ishin hartuar kryesisht në vitet 1983-1985. Në kuptim të zbatimit në praktikë të planeve të vjetra të mbarështimit është vërejtur se nuk pasqyrojnë ndryshimet që kanë ndodhur në fondin pyjor dhe kulloso si në volum, sipërfaqe, lloj pyjor, etj, në vitet e fundit. Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në referencë të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i cila ka përcaktuar si afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarështimit ka afatin 10 vjeçar. Planet e vjetra të mbarështimit nuk garantonjë një zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kulloso. Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore të pyjeve, kullotave dhe livadheve nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përbushur, për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global.

Në këto kushte gjatë një propozimi për financim nga Banka Botërore, e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila ka kontraktuar kompanitë Abkons dhe Oikon Croatia të cilat janë shpallur fituese për përgatitjen e disa planeve të menaxhmit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Korçë, të cilat janë selektuar nga Sektori i Pyjeve, aktualisht Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, janë përgatitur gjashtë plane mbarështrimi të ekonomive pyjore “Panarit – Treskë”,

“Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe ekonomisë kullosore “Rungajë”.

Pas realizimit planet e mbarështrimit të ekonomive pyjore dhe kullosore janë dorëzuar nga ana e kompanisë “Abkons dhe Oikon Croatia, në Bashkinë Korçë.

Detyrat që janë ndjekur nga subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë: Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore, përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse, Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes, Trungishte, Cungishte, Shkurre, vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës, vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta), identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve, identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë, eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zones, Hartografini i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë, Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes, Përdorimin e territorit të zones, Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve, Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit, Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre. Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit është menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Korçë (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit. Objektivat specifikë të planit të mbarështimit janë: Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat, Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor, Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues, Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues, Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit, Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme, Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrushme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.


Në këto kushte dhe bazuar në nenin 54 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016, për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave te inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”, në “Manualin e Planeve të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave” miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Janar 2019, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë planet e mbarështimit për ekonomitë pyjore Panarit –

Treskë", "Përparimaj – Dardhë", "Voskopojë", "Voskopojë 2", "Zëmbjak – Qarr" dhe ekonomisë kullosore "Rungajë".

Bashkëlidhur gjeni dhe një përbledhje të planeve të mbarështimit të këtyre ekonomive pyjore dhe kullosore.

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike  
dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)




**KRYETARI I BASHKISË**

**Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave**

Johan Marko



Sotiraq Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISE KORÇË

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE  
“PANARIT-TRESKË”, “PËRPARIMAJ-DARDHË”, “VOSKOPOJË”, “VOSKOPOJË2”,  
“ZËMLAK – QARR” DHE EKONOMISË KULLOSORE “RUNGAJË”.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave si dhe në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 55 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 115 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kulloso”, të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar:

V E N D O S I

- Të miratojë në parim planet e mbarështimit të ekonomive pyjore “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr”, dhe ekonomisë kullosore “Rungajë”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planeve të mbarështimit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_

# **PËRMBAJTIA E RAPORTIT FINAL MBI PLANET E MBARËSHTRIMIT TË EKONOMIVE PYJORE “PANARIT – TRESKË”, “PËRPARIMAJ – DARDHË”, “VOSKOPOJË”, “VOSKOPOJË 2”, “ZËMBLAK – QARR” DHE EKONOMISË KULLOSORE “RUNGAJË”, BASHKIA KORÇË.**

## **1. EKONOMIA PYJORE “PANARIT – TRESKË”.**

### **Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore.**

Ekonomia Pyjore “Panarit - Treskë” shtrihet në Jug-Perëndim të Bashkisë Korçë deri në kufirin me Bashkinë Çorovodë.

Kjo ekonomi e ka marrë emrin nga fshati Panarit dhe Treskë, që ndodhet pranë kësaj ekonomie. Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Panarit-Treskë , me periudhë vlefshmërie deri 2031, bëhet për herë të parë, pas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Panarit - Treskë viti 1983, si dhe pas hartimit të Planit të Menaxhimit të pyjeve Komunale (2007-2008), si pjesë e kësaj Ekonomie Pyjore. Sipas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Panarit - Treskë viti 1983, sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore ishte 3112 ha, nga e cila: Sipërfaqe Pyjore gjithsej 1112 ha, si dhe Sipërfaqe jo pyjore 2000 ha.

Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, tjetërsime të disa pjesë të n/ngastrave në pemëtore e toka bujqësore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar “Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore Panarit-Treskë rezultoi 3282.55 ha. Për këto arsyen, ishte urgjente hartimi i këtij Plani të ri Mbarështrimi, me synim menaxhim të qëndrueshëm, qeverisje e trajtim të pyjeve, dhe plotësim të gjithë funksioneve të tyre.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Panarit - Treskë . Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit përkatës, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

### **Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative.**

Ekonomia pyjore “Panarit - Treskë” ndodhet në jug- perëndim të qytetit të Korçës dhe bën pjesë në territorin e Bashkisë Korçë, Nj.A. Vithkuq.

Ka kufi të quartë natyralë, të tillë si maja, kurrise e qafa. Ajo kufizohet:

- Në jug kufizohet me fshatrat Treskë me koordinata vazhdon përgjatë lumit të Ballabanovës pranë fshatit Ballabanovë.
- Në lindje me Perroin e Zhutës, vazhdon me Qafën e Ujkut, kufi me Ek. Rrungajë.
- Në veri me qafën e Martës e vazhdon te maja e Azimës dhe vazhdon deri në Mashkullorë.

- Në perëndim me fshatin Panarit, vazhdon përgjatë kufirit të bashkisë Çorovodë, gurët e Bardhë.

### **Rezultatet kryesore**

Mbarështimi i ekonomisë pyjore “Panarit - Treskë” ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Përdorimi i teritorit	Njësia matëse	
		ha	%
1.	Sipërfaqe e mbuluar nga pyjet shtetërorë	898.73	27.4
2.	Sipërfaqe me pyje private	163.84	5
3.	Sipërfaqe e mbuluar nga shkurret	4.65	0.1
4.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	1 236.32	37.7
5.	Sipërfaqe bujqësore	146.17	4.5
6.	Sipërfaqe ujore	21.12	0.6
7.	Sipërfaqe urbane	15.36	0.5
8.	Sipërfaqe e zhveshur	690.44	21
9.	Sipërfaqe jo prodhuese	105.92	3.2
<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore</b>		<b>3 282.55</b>	<b>100</b>

**Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon :**

<b>A.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes</b>	<b>903.38 ha</b>
1.	Trungishte	773.28 ha
2.	Cungishte	125.45 ha
3.	Shkurre	4.6 ha
<b>B.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas funksionit</b>	<b>903.38 ha</b>
1.	Pyje prodhues	601.81 ha
2.	Pyje mbrojtës	301.57 ha
<b>C.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas origjinës</b>	<b>903.38 ha</b>
1.	Pyje natyrore	898.73 ha
2.	Pyje artificiale	4.65 ha

Pyjet tē propozuar me funksion mbrojtës janë pyllëzime artificiale Pishë tē Zezë dhe pyje me pjerrësi tē madhe me Pishë tē Zezë dhe Ah pér mbrojtjen e tokës nga erozioni hidrik, tē ujërave, liqeneve, tē zbutjes së klímës, etj.

#### **Tipet e pyjeve pérbejnë masivet pyjore tē ekonomisë janë :**

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit tē sipërfaqes pyjore jepen:

Tipi i Grumbullit	Funksioni					
	Total		Prodhues		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje tē dominuara nga Ahu (Fagus sylvatica L.)	563.72	62.7	478.69	53.3	85.03	9.4
Pyje tē dominuara nga Pisha e zezë (Pinus nigra Arn.)	335.01	37.3	118.47	13.2	216.54	24.1
<b>TOTALI</b>	<b>898.73</b>	<b>100.0</b>	<b>597.16</b>	<b>66.5</b>	<b>301.57</b>	<b>33.5</b>

Sipërfaqen më tē madhe e zënë pyjet e dominuar nga lloji ah.

#### **Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e më poshtëm :**

Pyje gjithsej	903.38 ha
Volumi i përgjithshëm	70 680 m <sup>3</sup>
Lëndë punimi	63 174 m <sup>3</sup>
Dru zjarri	7 506 m <sup>3</sup>

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rreth 70 680 m<sup>3</sup>.

#### **Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit**

Mundësia e shfrytëzimit përfaqëson në vetvete sasinë e materialit drusor që do tē vilet çdo vit nga ekonomia në kuadrin e ciklit tē prodhimit pa cënuar multifunkcionet e pyllit në dobi tē shoqërisë dhe vijueshmërinë e prodhimeve drusore e jo drusore. Sasia vjetore e prerjes do tē jetë ajo që do tē rezultojë nga përllogaritjet me metodat e njohura tē mbarështrimit, duke i shtuar kësaj edhe sasinë e materialit drusor, që do tē dalë nga kryerja e punimeve silvikulturale, pastrime e rrallime, tē cilat në nivel ekonomie kapin shifrën rreth **1 485 m<sup>3</sup>** në vit.

## **Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve**

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësimë.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrotjtës të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së perkujdesjes për pyjet.
- Rritja e invenstimeve dhe gjendjes se perkujdesjes.

## **Objektivat specifik silvikulturale**

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërvhetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistonë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

## **Përfundime**

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në projekt janë propozuar punime të ndryshme si rrallime parakomerciale dhe komerciale, heqje barëtrash nga kullota ,etj në 32 nën parcela në një sipërfaqe prej 578.24 ha duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike të trajtimit silvikulturor që krahas vjeljes së materialit drusor me rreth 14 847 m<sup>3</sup> dru zjarri, të sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve të ekonomisë pyjore Panarit Treskë.

## 2. EKONOMIA PYJORE “PËRPARIMAJ – DARDHË”

### Informacion i pergjithshem rreth Ekonomise pyjore

Ekonomia pyjore “Perparimaj-Dardhë” shtrihet në territorin e Bashkisë “Korçë”, dikur administrohej nga DSHP Korçë. Siperfaqja totale e ekonomisë pyjore Perparimaj-Dardhë është 748.24 ha. Plani i mbareshtrimit eshte i vlefshem për periudhën kohore deri 2031. Plani i ri i mbarështrimit hartohet sepse kemi një ndarje të re territoriale administrative dhe ndryshim kufijesh, gjithashtu plani i vjeter i mbarështrimit të pyjeve e ka humbur vlefshmërine që prej shumë vitesh, por edhe plani i mbarështrimit të pyjeve komunal të Njësisë administrative Drenovë e ka humbur që prej një viti vlefshmerinë e tij. Një tjeter arsyё eshtë se bashkia Korçë ka siguruar mbështetje financiare për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në territorin e saj. Ekonomia pyjore është me të njejtin emer dhe nga plani i mbarështrimit të pyjeve komunal të njësisë administrative Drenovë ka patur një sipërfaqe totale prej 2 146.10 ha, nga i cili fshati Dardhë ka patur 713.90 ha ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrin në 748.24 ha. Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qëllim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale të mprehta të zonës ku do të kryhet mbarështrimi, në mënyre që të gjejnë pasqyrim në objektivat e mbarështrimit për të ardhmen. Mbarështrimi i grumbujve pyjore të ekonomisë pyjore “Pérparimaj-Dardhë” ka synuar dhe synon që nëpërmjet zbatimit të një silvikulture natyralistike të garantojë strukturën shumëmoshare, të ruajë biodiversitetin në përputhje me karakteristikat ekologjike stacionale, të sigurojë vijueshmërinë e prodhimeve të pyllit dhe veçanërisht riperteritjen natyrore dhe shumë funksione të grumbujve pyjore.

### Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Pérparimaj -Dardhë shtrihet në jug-lindje të qytetit të Korçës si dhe në faqen perendimore të malit Morava. Teritori i saj fillon nga 1230 m mbi nivelin e detit dhe arrin në 1798.6 m në majën e Rrumbullakët në veri të fshatit Dardhë. Ekonomia pyjore është e vendosur në një relief të aksidentuar, të larmishëm e dinamik dhe malor. Ekonomia ka kufij natyrorë të qartë si me poshtë:

- **Në Veri:** Territorin e fshatit Drenovë
- **Në Lindje:** Teritore të fshatit Sinicë - Miras të rrëthit Devoll
- **Në Jug:** Teritore të fshatit Arrëz - Miras të rrëthit Devoll
- **Në Perëndim:** Territore të fshatit Boboshticë

### Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore “Pérparimaj – Dardhë” ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Ekonomia pyjore ka një sipërfaqje totale prej 748.24 ha nga e cila 728.84 ha ose 97.4% janë pyje dhe 12.10 ha ose 1.6 % e sipërfaqes janë kullotë, sipërfaqja prej 53.80 ha janë pyje të

djegur me parë por të ripërtërirë si dhe siperfaqja prej 36.40 ha që janë pyjet të prera rrah. Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloso paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Përdorimi i teritorit	Njësia matëse	
		ha	%
	<b>Sipërfaqe pyjore total</b>	<b>728.84</b>	<b>97.4</b>
1.	Sipërfaqe me pyje	638.64	85.3
2.	Sipërfaqe me pyje të prera rrah/ të ripërtërira	36.40	4.9
3.	Sipërfaqe me pyje të djegur/ ripërtëri	53.80	7.2
4.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	12.10	1.6
5.	Sipërfaqe djerr (eroduar) inproduktive	7.30	1
6.	Sipërfaqe urbane, bujqësore	0	0
	<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore</b>	<b>748.24</b>	<b>100</b>

Nisur nga të dhenat e mbulesës së tokës jashtë territorit të ekonomisë pyjore “Përparimaj-Dardhë” kemi edhe territore të tjera, që rezultojnë të kenë një siperfaqe të përgjithëshme prej 300.09 ha.

**Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:**

A.	<b>Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes</b>	<b>728.84 ha</b>
1.	Trungishte	43.85 ha
2.	Cungishte	218.04 ha
3.	Trungishte e përberë	147.31 ha
4.	Cungishte e përberë	319.64 ha
B.	<b>Pyje gjithsej sipas funksionit</b>	<b>728.84 ha</b>
1.	Pyje prodhues	356.85 ha
2.	Pyje mbrojtës	371.99 ha

Pyjet me funksion mbrojtës zënë 398.49 ha ose 54.7 % kurse ata me funksion prodhues zënë 330.35 ha ose 45.3% të sipërfaqes pyjore. Grumbujt pyjore të kësaj ekonomie qeverisen si me poshtë:

- Pyjet trungishte zënë 43.85 ha ose 6 % të sipërfaqes pyjore
- Pyjet cungishte 218.04 ha ose 29.9% të sipërfaqes pyjore
- Pyjet cungishte e përbërë (Cung + Trung) zënë 319.64 ha ose 43.9 % të sipërfaqes pyjore

- Pyjet trungishte e përbërë (Trung + Cung) zënë 147.31 ha ose 20.2 % të sipërfaqes pyjore

**Tipet e pyjeve përbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë :**

Brenda ekonomisë pyjore tipet e pyjeve aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen :

Tipi i pyjeve	Funksioni					
	Total		Prodhues		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje të dominuara nga Ahu (Fagus sylvatica L.)	660.76	90.7	329.11	45.2	331.65	45.5
Pyje të dominuara nga Pisha e zezë (Pinus nigra Arn.)	57.51	7.8	1.24	0.1	56.27	7.7
Pyje të dominuar nga Bredhi (Abies alba)	10.57	1.5	0	0	10.57	1.5
<b>TOTALI</b>	<b>728.84</b>	<b>100.0</b>	<b>330.35</b>	<b>45.3</b>	<b>398.49</b>	<b>54.7</b>

Sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet e dominuar nga lloji ah.

**Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;**

Pyje gjithsej janë 728.84 ha dhe volum 70414 m<sup>3</sup> nga të cilët sipas formës së qeverisjes; Trungishte 43.85 ha me volum 4920 m<sup>3</sup>, Cungishte 218.04 ha, me volum 21496 m<sup>3</sup>, (Trung + Cung) 147.31 ha, me volum 7891 m<sup>3</sup> dhe (Cung.+ Trung.) 319.64 ha, me volum 36107 m<sup>3</sup>.

Nr.	Lloji pyjore	Fondi Pyjor			
		Siperfaqia Ha	%	Volumi m <sup>3</sup>	%
1.	Ah	515.30	70.7	45542	64.7
2.	Pishë e zezë	67.82	9.3	8909	12.7
3.	Fletore të tjerë (mështekna,etj)	60.55	8.3	6367	9.0
4.	Halarë të tjerë (bredhi, etj)	85.17	11.7	9596	13.6
<b>Volumi total</b>		<b>728.84</b>	<b>100</b>	<b>70414</b>	<b>100</b>

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rreth 70 414 m<sup>3</sup>.

**Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit**

Sipas përllogaritjeve për ekonominë e marrë në studim, si biomasë në dispozicion për plotesimin e nevojave energjitetike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat silvikulturore të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky plan mbarështrimi. Pra përfitohet një sasi biomasë prej 1 926.7 m<sup>3</sup>/vit si mundësi vjetore vjeljes së lëndës drusore.

## **Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve**

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatese nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën.)
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje të njëpasnjëshme, prerje rrah dhe përmirësimi.
- Ruajtjes së biodiversitetit, të florës e faunës.
- Mbrojtjes së pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa lejë.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmiresimit të gjëndjes së përkujdesjes për pyjet.

## **Objektivat specifik silvikulturale**

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimale të pyjeve.

Do të kryhen një sëre punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllezime artificiale. Më anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentet së bashku (tekniqe dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistonë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjore.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

## **Përfundime**

Në aspektin e organizimit natyror kjo ekonomi paraqet një ndërthurje të mirë të elemeneve ekstensiv dhe intensive të menaxhimit të burimeve pyjore, kullotave, fondit bujqësor, ujera, florës, faunës dhe mbi të gjitha faktorit njeri si përfitues, përdoruës i këtyre burimeve. Pavarësisht kesaj, kërkohet një edukim i vazhdueshem për menaxhimin e qëndrueshem dhe vënien në funksion të përmiresimit të cilësisë së jetesës për komunitetin të këtyre burimeve.

### **3. EKONOMIA PYJORE “VOSKOPOJË”**

#### **Informacion i përgjithshëm rrreth Ekonomisë Pyjore**

Ekonomia Pyjore “Voskopojë” shtrihet në atë pjesë të basenit ujëmbledhes të lumit Osojë, që formohet nga disa përrenj, të cilët e furnizojnë atë në rrjedhën e sipërme të tij.

Kjo ekonomi e ka marrë emrin nga fshati Voskopojë, që ndodhet në qendër të saj.

Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë, me periudhë vlefshmërie deri 2031, bëhet për herë të parë, pas Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë viti 1990, si dhe pas hartimit të Planit të Menaxhimit të pyjeve Komunale (2007-2008), si pjesë e kësaj Ekonomie Pyjore. Sipas Planit të Menaxhimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë viti 1990, sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore ishte 622.2 ha, nga e cila: Sipërfaqe Pyjore gjithsej 409.1 ha, si dhe Sipërfaqe jo pyjore 213.13 ha.

Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, tjetërsime të disa pjesë të n/ngastrave në pemëtore e toka bujqësore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar “Manuali i planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave”, janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore Voskopojë rezultoi 976.74 ha. Për këto arsy, ishte urgjente hartimi i këtij Plani të ri Mbarështrimi, me synim menaxhim të qëndrueshëm, qeverisje e trajtim të pyjeve, dhe plotësim të gjithë funksioneve të tyre.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Voskopojë. Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit përkatës, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

#### **Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative**

Ekonomia pyjore “Voskopojë” ndodhet në perëndim të qytetit të Korçës dhe bën pjesë në Nj.A. Voskopojë. Ka kufi të qartë natyralë, të tillë si maja, kurrize e qafa. Ajo kufizohet:

- Në jug Përgjatë shpatit mbi fshatin Gjonomadh dhe rrugës nationale të fshatit Voskopojë.
- Në lindje me majën e Shipckës 1601 m, vazhdon në drejtim të fshatit Gjonomadh.
- Në veri me Ekonominë Pyjore Voskopojë bashkimi i lumit të Voskopojës me Përroin e Grigorit.
- Në perëndim me rrugën e Voskopojës, vazhdon përgjatë rrugës së Voskopojës deri te bashkimi i lumit të Voskopojës me pérroin e Grigorit.

## Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Voskopojë" ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Përdorimi i teritorit	Njësia matëse	
		ha	%
1.	Sipërfaqe e mbuluar nga pyjet shtetërore	249.54	25.5
2.	Sipërfaqe me pyje private	205	21
3.	Sipërfaqe e mbuluar nga shkurret	0	0
4.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	360.85	37
5.	Sipërfaqe bujqësore	148	15.1
6.	Sipërfaqe ujore	0.75	0.1
7.	Sipërfaqe urbane	0	0
8.	Sipërfaqe e zhveshur	5.6	0.6
9.	Rrugë	7	0.7
<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore</b>		<b>976.74</b>	<b>100</b>

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

A.	<b>Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes</b>	<b>249.54 ha</b>
1.	Trungishte	249.54 ha
2.	Cungishte	0 ha
3.	Shkurre	0 ha
B.	<b>Pyje gjithsej sipas funksionit</b>	<b>249.54 ha</b>
1.	Pyje prodhues	249.54 ha
2.	Pyje imbrojtës	0 ha
C.	<b>Pyje gjithsej sipas origjinës</b>	<b>249.54 ha</b>
1.	Pyje natyrore	249.54 ha
2.	Pyje artificiale	0 ha

### **Tipet e pyjeve pérbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë:**

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen :

Tipi i Grumbullit	Funksioni					
	Total		Prodhuar		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje të dominuara nga Pisha e zezë (Pinus nigra Arn.)	249.54	100	249.54	100	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>249.54</b>	<b>100</b>	<b>249.54</b>	<b>100</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Sipërfaqen totale e zënë pyjet e dominuar nga lloji Pishë e Zezë.

### **Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:**

Pyje gjithsej	249.54 ha
Volumi i përgjithshëm	29 641.24 m <sup>3</sup>

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rrëth 29 641.24 m<sup>3</sup>.

### **Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzim**

Mundësia e shfrytëzimit përfaqëson në vetvete sasinë e materialit drusor që do të vilet çdo vit nga ekonomia në kuadrin e ciklit të prodhimit pa cënuar multifunkcionet e pyllit në dobi të shoqërisë dhe vijueshmërinë e prodhimeve drusore e jo drusore.

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me Metodën silvikulturale është 535.6 m<sup>3</sup> në vit.

Mundësia e shfrytëzimit e llogaritur siguron zhvillim të qëndrueshëm të grumbujve pyjore të ekonomisë dhe vijueshmëri prodhimi të materialit drusor, pasi ajo rezulton më e vogël se rritja vjetore e grumbujve të ekonomisë pyjore e cila është 648.8 m<sup>3</sup>.

### **Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve**

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjendje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësimi.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.

- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

### **Objektivat specifik silvikulturale**

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërvhetuar të gjithë komponentët së bashku (tekniqe dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistonjë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

### **Përfundime**

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në projekt janë propozuar punime të ndryshme si rrallime tregëtare dhe pastrim kullotash në 17 nën parcela në një sipërfaqe prej 377.14 ha duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike të trajtimit silvikulturor që krahas vjeljes së materialit drusor me rreth 5356.6m<sup>3</sup> material drusor, të sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve të ekonomisë pyjore Voskopojë.

## **4. EKONOMIA PYJORE “VOSKOPOJË 2”**

### **Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore**

Ekonomia Pyjore “Voskopojë 2” shtrihet në ate pjesë të basenit ujëmbledhes të lumit të Voskopojës, që formohet nga disa perrenj, të cilët e furnizojnë atë në rrjedhën e siperme të tij. Kjo ekonomi e ka marrë emrin nga fshati Voskopojë, që ndodhet në qënder të saj.

Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë 2, me periudhë vlefshmërie deri 2031, bëhet për herë të parë, pas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë viti 1985, si dhe pas hartimit të Planit të Menaxhimit të pyjeve Komunale (2007-2008), si pjesë e kësaj Ekonomie Pyjore. Sipas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Voskopojë 2 viti 1985, sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore ishte 9005.5 ha, nga e cila: Sipërfaqe Pyjore gjithsej 2637.75 ha, si dhe Sipërfaqe jo pyjore 6367.75 ha.

Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, tjetërsime të disa pjesë të n/ngastrave në pemëtore e toka bujqësore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar “Manuali i planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave”, janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore Voskopojë 2 rezultoi 4863 ha. Për këto arsy, ishte urgjente hartimi i këtij Plani të ri Mbarështrimi, me synim menaxhim të qëndrueshëm, qeverisje e trajtim të pyjeve, dhe plotësim të gjithë funksioneve të tyre.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Voskopojë 2. Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit përkatës, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

### **Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative**

Ekonomia pyjore “Voskopojë 2” ndodhet në perëndim të qytetit të Korçës dhe bën pjesë në territorin e Bashkia Korçë, Nj.A. Voskopojë.

Ka kufi të qartë natyralë, të tillë si maja, kurrise e qafa. Ajo kufizohet:

- Në jug fillon me rrugën nationale të fshatit Gjergjevicë, vazhdon përgjatë prroit të Korës pranë fshatit Gjergjevicë.
- Në lindje me Lëmin e Gjurasit, vazhdon me Lumin e sulës, rruga e fshatit Shipckë, bashkimi i Lumit të Sulës me Lumin e Voskopojës.

- Në veri me lumin e Cemericës e vazhdon me kufirin e Bashkisë Maliq dhe ndjek kufirin administrativ me Bashkinë Maliq, Maja e Sukoverit, Lumi i Bodesë, Kasollet e Bodesë, Maja Plerinat, Lëmi i Gjurasit.
- Në perëndim me fshatin Gjergjevicë, përroi i Korës, vazhdon përgjatë përroit të Gjergjevicës, Xerje Denas-Karbanjos-Lavdari (Poponivë), kufi me Bashkinë Maliq, Lumi i Cemericës.

### **Rezultatet kryesore**

Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Voskopojë 2" ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloso paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	<b>Përdorimi i teritorit</b>	<b>Njësia matëse</b>	
		<b>ha</b>	<b>%</b>
1.	Sipërfaqe e mbuluar nga pyjet	2 202.98	45.3
2.	Sipërfaqe e mbuluar nga shkurret	1 647.97	33.8
3.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	417.9	8.5
4.	Sipërfaqe bujqësore	185	3.8
5.	Sipërfaqe ujore	10.02	0.4
6.	Sipërfaqe urbane	8.6	0.2
7.	Sipërfaqe e zhveshur	224.75	4.6
8.	Sipërfqaqe boshe (pyllëzim)	165.82	3.4
<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore</b>		<b>4 863</b>	<b>100</b>

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

<b>A.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes</b>	<b>3 850.95 ha</b>
1.	Trungishte	1 747.01 ha
2.	Cungishte	455.97 ha
3.	Shkurre	1647.97 ha
<b>B.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas funksionit</b>	<b>3 850.95 ha</b>
1.	Pyje prodhues	1861 ha
2.	Pyje mbrojtës	1989.9 ha

<b>C.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas origjinës</b>	<b>3 850.95 ha</b>
1.	Pyje natyrore	2885.2 ha
2.	Pyje artificiale	965.75 ha

#### Tipet e pyjeve pérbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë :

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen:

Tipi i Grumbullit	Funksioni					
	Total		Prodhues		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje dominuar nga Ahu (Fagus sylvatica)	64.4	1.6	62.34	1.6	2.05	0.05
Pyje dominuar nga Pisha e zezë (Pinus nigra)	1730.55	44.9	1179.82	30.6	551.26	14.3
Shkurre dominuar nga Bushi (Buxus sempervirens)	1100.14	28.6	163.14	4.2	937.00	24.3
Shkurre dominuar nga Fagus sylvatica	59.32	1.54	55.82	1.4	3.50	0.09
Shkurre dominuar nga Shkoza e zezë (Carpinus orientalis)	133.98	3.47	13.08	0.3	120.09	3.1
Shkurre dominuar nga Dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus)	211.63	5.5	143.59	3.7	68.03	1.7
Shkurre dominuar nga Shparthi (Quercus frainetto Ten.)	142.91	3.7	60.33	1.6	82.58	2.1
<b>TOTALI</b>	<b>3850.95</b>	<b>100.0</b>	<b>1862</b>	<b>48.1</b>	<b>1988.9</b>	<b>51.44</b>

Sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet e dominuar nga lloji Pishë e zezë dhe shkurre dominuar me Bush.

#### Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;

<b>Pyje gjithsej</b>	<b>3 850.95 ha</b>
<b>Volumi i përgjithshëm</b>	<b>168 409 m<sup>3</sup></b>
<b>Lëndë punimi</b>	<b>152 373 m<sup>3</sup></b>
<b>Dru zjarri</b>	<b>16 036 m<sup>3</sup></b>

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rrëth 168 409 m<sup>3</sup>.

## **Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzim**

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me Metodën silvikulturale është  $52\ 981\ m^3$ .

Pra  $0\ m^3$  vilet nga grumbujt në dhe mbi moshën e shfrytëzueshmërisë dhe  $52\ 981\ m^3$  vilet nga ndërhyrjet silvikulturore.

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me metodën Mason-Mantel është  $40\ 79.71\ m^3$ .

Mundësia e shfrytëzimit e llogaritur me këto dy metoda siguron zhvillim të qëndrueshëm të grumbujve pyjore të ekonomisë dhe vijueshmëri prodhimi të materialit drusor, pasi ajo rezulton më e vogël se rritja vjetore e grumbujve të ekonomisë pyjore e cila është  $10\ 622\ m^3$ .

## **Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve**

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësimi.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

## **Objektivat specifik silvikulturale**

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërshtuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistonë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

Të dhënrat për sipërfaqen dhe koston e çdo objektivi jepen në kapitujt përkatës.

## Përfundime

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në projekt janë propozuar punime të ndryshme si pyllëzime me llojet pishë të zezë, panjë malin, si dhe rrallime komerciale, ricungime,etj në 162 nën parcela në një sipërfaqe prej 2 460.6 ha duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike të trajtimit silvikulturor që krahas vjetes së materialit drusor me rreth 52 981 m<sup>3</sup> dru zjarri, të sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve të ekonomisë pyjore Voskopojë 2.

## 5. EKONOMIA PYJORE “ZËMBLAK – QARR”

### Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia Pyjore “Zëmlak-Qarr” shtrihet mbi fushën e Korçës fillon që në afersi të fshatit Zëmlak dhe përfundon në fshatin Pulahë. Kjo ekonomi e ka marrë emrin nga fshati Zëmlak dhe zona e Qarrit që ndodhet në kufi me Kolonjën. Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Zëmlak-Qarr, me periudhë vlefshmërie deri 2031, bëhet për herë të parë, pas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Zëmlak-Qarr viti 1985, si dhe pas hartimit të Planit të Menaxhimit të pyjeve Komunale (2007-2008), si pjesë e kësaj Ekonomie Pyjore. Sipas Planit të Menaxhimit të Ekonomisë Pyjore Zëmlak-Qarr viti 1985, sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore ishte 11045 ha, nga e cila: Sipërfaqe Pyjore gjithsej 4931 ha, si dhe Sipërfaqe jo pyjore 6114 ha. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, tjetërsime të disa pjesëve të n/ngastrave në pemëtore e toka bujqësore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar “Manuali i planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave”, janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore Zëmlak-Qarr rezultoi 15648.1 ha. Për këto arsy, ishte urgjente hartimi i këtij Plani të ri Mbarështrimi, me synim menaxhimin e qëndrueshëm, qeverisjen e trajtimin e pyjeve, dhe plotësimin e të gjithë funksioneve të tyre.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Zëmlak-Qarr. Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit përkatës, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

## Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore “Zëmblak-Qarr” ndodhet në lindje të qytetit të Korçës dhe bën pjesë në territorin e Bashkia Korçë, Nj.a. Mollaj, Drenovë dhe Bulgarec.

Ka kufi të qartë natyralë, të tillë si maja, kurrise e qafa. Ajo kufizohet:

- Në jug me Qafën e Qarrit ku ndahet ekonomia pyjore dhe Bashkia e Korçës me Bashkinë Kolonjë.
- Në lindje me kurrizin e malit të Moravës që fillon mbi Zëmblak dhe deri në maja e Bigllës, me majën e Malit të Kuq dhe deri në majën e Qarrit.
- Në veri me Ekonominë Pyjore Zëmblak - Mali i Thatë e deri në Ekonominë Pyjore Zëmblak Vërlen.
- Në perëndim me fushën e Korçës dhe të Maliqit që fillon që në fshatin Floq deri në fshatin Plasë.

## Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore “Zëmblak-Qarr” ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloso paraqitet si më poshtë vijon :

Nr.	Përdorimi i teritorit	Njësia matëse	
		ha	%
1.	Sipërfaqe e mbuluar nga pyjet	6 173.12	39.4
2.	Sipërfaqe e mbuluar nga shkurret	741.04	4.7
3.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	3 250.53	20.8
4.	Sipërfaqe bujqësore	2 682	17.1
5.	Sipërfaqe jo pyjore	1 816.43	11.6
6.	Sipërfaqe e zhveshur	984.99	6.4
	<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore</b>	<b>15 648.1</b>	<b>100</b>

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

A.	Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes	<b>6 914.16 ha</b>
1.	Trungishte	2 936.72 ha

2.	Cungishte	3 236.4 ha
3.	Shkurre	741.04 ha
<b>B.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas funksionit</b>	<b>6 914.16 ha</b>
1.	Pyje prodhues	5 814.23 ha
2.	Pyje mbrojtës	1 099.93 ha
<b>C.</b>	<b>Pyje gjithsej sipas origjinës</b>	<b>6 914.16 ha</b>
1.	Pyje natyrore	5 733.21 ha
2.	Pyje artificiale	1 180.95 ha

**Tipet e pyjeve përbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë :**

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen :

Tipi i Grumbullit	Funksioni					
	Total		Prodhues		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje të dominuar nga Pishë e Zezë ( <i>Pinus nigra Arn.</i> )	2204.68	35.7	1503.36	24.3	701.33	11.4
Pyje të dominuar nga Shkoza e zezë ( <i>Carpinus orientalis Mill.</i> )	84.34	1.4	84.34	1.4		0.0
Pyje të dominuar nga Bredh i bardhë ( <i>Abies alba Mill.</i> )	449.27	7.3	449.27	7.3		0.0
Pyje të dominuar nga Ahu ( <i>Fagus sylvatica L.</i> )	2417.51	39.2	2132.72	34.6	284.79	4.6
Pyje të dominuar nga Shkoza e bardhë ( <i>Carpinus betulus L.</i> )	24.31	0.4	24.31	0.4		0.0
Pyje të dominuar nga Bredhi i Maq. ( <i>Abies borisii-regis Matt.</i> )	71.3	1.2	71.3	1.2		0.0
Pyje të dominuar nga Gështenja ( <i>Castanea sativa Mill.</i> )	92.21	1.5	92.21	1.5		0.0
Pyje të dominuar nga Lajthia e butë ( <i>Corylus avellana L.</i> )	6.22	0.1	6.22	0.1		0.0
Pyje të dominuar nga Qarri ( <i>Quercus cerris L.</i> )	551	8.9	501.04	8.1	49.96	0.8
Pyje të dominuar nga (Acer pseudoplatanus L.)	21.9	0.3	21.9	0.3		0.0
Pyje të dominuar nga Bunga ( <i>Quercus petraea L.</i> )	87.22	1.4	78.31	1.3	8.91	0.1

Pyje të dominuar nga Bulgeri (Quercus trojana.)	79.35	1.3	79.35	1.3		0.0
Pyje të dominuar Mëlleza (Ostrya carpinifolia Scop.)	83.81	1.3	39.61	0.6	44.2	0.7
<b>TOTALI</b>	<b>6173.12</b>	<b>100.0</b>	<b>5083.94</b>	<b>82.4</b>	<b>1089.18</b>	<b>17.6</b>

Sipërfaqen më të madhe e zë pyjet e dominuar nga lloji Pishë e Zezë dhe pyjt e Ahut përkatësisht 35.7% dhe 39.2%.

#### Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;

<b>Pyje gjithsej</b>	<b>6 914.16 ha</b>
<b>Volumi i përgjithshëm</b>	<b>227 334 m<sup>3</sup></b>
<b>Lëndë punimi</b>	<b>138 229.7 m<sup>3</sup></b>
<b>Dru zjarri</b>	<b>89 104.3 m<sup>3</sup></b>

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rreth 227 334 m<sup>3</sup>.

#### Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzim

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me metodën Mason-Mantel është 5 425.1 m<sup>3</sup>

Mundësia e shfrytëzimit e llogaritur me këto dy metoda siguron zhvillim të qëndrueshëm të grumbujve pyjore të ekonomisë dhe vijueshmëri prodhimi të materialit drusor, pasi ajo rezulton më e vogël se rritura vjetore e grumbujve të ekonomisë pyjore e cila është 20 163 m<sup>3</sup>.

#### Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjendje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësimi.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrotjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimi të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

## **Objektivat specifik silvikulturale**

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërvhetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistonjë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

## **Përfundime**

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në projekt janë propozuar punime të ndryshme si rrallime paratregëtare, rrallime tregëtare, pastrime, pastrim kullotash, ndërtim lerash, sistemime malore në 246 nën parcela në një sipërfaqe prej 4 272.03 ha duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike të trajtimit silvikulturor që krahas vjeljes së materialit drusor me rreth 35 376.98 m<sup>3</sup> materjal drusor, të sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve të ekonomisë pyjore Zëmlak-Qarr.

## 6. EKONOMIA KULLOSORE “RUNGAJË”

### Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia pyjore dhe kullosore “Rungajë” shtrihet brënda njësisë administrative Vidhkuq. Njësia administrative e Vithkuqit shtrihet në jugperëndim të Bashkisë së Korçës. Njësia administrative Vidhkuq përfaqësohet nga 12 fshatra, nga fshati Vithkuq, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Gjanç, Leshnjë, Shtyllë, Panarit, Trebickë, Grabockë, Treskë, Katund. Për herë të fundit ekonomia pyjore dhe kullosore “Rungajë” është inventarizuar në vitin 1981, e cila më parë ka qënë një ekonomi kullosore “Rungajë - Vidhkuq” por gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe kullosore të saj ku bimësia pyjore ka evoluar dhe ka populluar dhe veshur këto parcela kullosore. Nga pani i inventarizimit të viti 1981 për ekonominë kullosore “Rungajë” kemi një sipërfaqe totale prej 2432 ha nga këto 1180 ha i përkisnin ish Nd.Pyjore dhe 1252 ha ishin sip. kolektive. Ndërsa sipërfaqja e re e Ekonomisë pyjore dhe kullosore “Rungajë” do të jetë 1468.66 ha e cila shtrihet në 7 prej 12 fshatrave e njësisë administrative Vidhkuq. Në planin e ri të mbarështrimit të ekonomisë pyjore dhe kullosore “Rungajë” nuk janë përfshirë të gjitha ngastrat ekzistuese të ish-EK kullosore “Rungajë”. Veri Maja e Lisecit, në jug fshati Roshanj dhe Kodra e Qafzezit, në lindje Maja e Ljovës, në perëndim Maja e rrungajes, Përroi i rrungajes.

### Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Shtrirja territoriale e ekonomisë pyjore dhe kullosore “Rungajë” përshkon dhe disa fshatra të njësisë administrative Vidhkuq, në jugperëndim të Bashkisë së Korçës dhe ka një sipërfaqe prej **1468.66 ha**. Shumica e pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë “Rungajë”, ndodhen në zonën fitolimatike të gështenjës dhe ahut dhe shtrihet nga lartësia 800 m-1800 m mbi nivelin e detit. Ekonomia “Rungajë” ka kufinj natyror të kufizuar me:

- Në Veri me ekonomitë pyjore Lavdar – Opar, EP. Voskopojë, EP. Maliq-Dërsnik
- Në Lindje me ekonomitë pyjore Zëmlak-Qarr, EP. Qarr-Kozel
- Në Jug me ekonomitë pyjore Çlirim, EP Ballabanovë
- Në Perëndim me ekonomitë pyjore Panarit – Treskë, EP Sherre

### Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore “Zëmlak-Qarr”ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarështrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon :

Nr.	Përdorimi i teritorit	Njësia matëse	
		ha	%
1.	Sipërfaqe e mbuluar nga pyjet	253.91	17.3
2.	Sipërfaqe e mbuluar nga shkurret	44.94	3.1
3.	Sipërfaqe e mbuluar nga kullotat	1 063.82	72.4
4.	Sipërfaqe jo pyjore	99.47	6.8
5.	Sipërfaqe e zhveshur	6.52	0.4
	<b>Sipërfaqja totale e ekonomisë</b>	<b>1 468.66</b>	<b>100</b>

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

Nr.	Pyje gjithsej sipas formës së qeverisjes	298.85 ha
1.	Trungishte	66.33 ha
2.	Trungishte e perb.	23.98 ha
3.	Cungishte	161.12 ha
4.	Cungishte e përberë	2.48 ha
5.	Shkurre	44.94 ha

Tipet e pyjeve përbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë :

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen :

Tipi i Grumbullit	Funksioni					
	Total		Prodhues		Mbrojtës	
	ha	%	ha	%	ha	%
Pyje dominuar nga Ahu (Fagus sylvatica L.)	153.18	60.3	145.3	57.3	7.7	3.0
Pyje dominuar nga Pisha e zezë (Pinus nigra Arn.)	85.362	33.6	85.362	33.6		
Pyje dominuar nga lloje të tjera	15.368	6.1	15.368	6.1		
<b>Totali</b>	<b>253.91</b>	<b>100</b>	<b>246.21</b>	<b>97</b>	<b>7.7</b>	<b>3</b>

Llojet kryesore që vegjetojnë natyralisht janë Pisha e zeze, Ahu, si dhe kemi prani te llojeve si Qarri, Bung-Buta, Bunga, Panja, Frashëri, Mëlleza, Lajthia, Dëllinja e kuqe-zezë, Murrizi, Trendafili i eger etj.

### Tipet e kullotave

Ekonomia pyjore dhe kullosore “Rrungajë” duke qënë se më parë ka qënë një ekonomi kullosore “Rrungajë” në territorin e saj ka sipërfaqe të konsiderueshme kullotash natyrore kryesisht verore. Kullotat zënë një vënd të rëndësishëm në mbarështrimin e blektorisë së imët të zonës të cilave u plotësojnë rreth 65% të nevojave të bazës foragjere. Kullotat mund ti ndajmë të dobishme dhe të padobishme verore dhe kullota dimërore. Kullotat e zonës së Vidhkuqit përmënden ndër kullotat më mira dhe janë kullota që në përgjithësi përdoren nga vetë banorët e fshatrave përreth. Në Ekonominë “Rrungajë” kemi një sipërfaqe totale kullësore prej 1063.82 ha.

Tipi i Kullotës	Sipërfaqja ha	% ndaj Sip totale të Kullotave	% ndaj Sip totale të ekonomisë pyjore
Kullota verore	1063.82	100	72.4
Kullota dimërore	-	-	-
<b>Totalë</b>	<b>1063.82</b>	<b>100</b>	<b>72.4</b>

Paraqitura e shpërndarjes së llojeve të kullotave në %.

Emërtimi	Sipërfaqja ha	% ndaj Sip totale të Kullotave
Kullotë	539.31	50.7
Me shkurre	384.1	36.1
Kullotë me pemë	137.69	12.9
Livadh	2.72	0.3
<b>Totali</b>	<b>1063.82</b>	<b>100</b>

Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;

Pyje gjithsej	298.85 ha
Volumi i përgjithshëm	13291.3 m <sup>3</sup>

Vëllimi drusor në këmbë i pyjeve të Ekonomisë pyjore dhe kullosore “Rrungajë” në total është 13291.3m<sup>3</sup>

### **Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzim**

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me metodën Mason-Mantel është 221.52m. Mundësia e shfrytëzimit e llogaritur me këtë metodë siguron zhvillimin e qëndrueshëm të grumbujve pyjore të ekonomisë dhe vijueshmëri prodhimi të materialit drusor, pasi ajo rezulton më e vogël se rritja mesatare vjetore 264.9 m<sup>3</sup>/ha dhe grumbujve të ekonomisë pyjore e cila është 1750m<sup>3</sup>.

### **Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve**

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjendje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime pastrime, rrallime tregëtarë, parakomerciale etj.)
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje e përmirësimë.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet dhe përdorimit optimal të stacionit.

### **Objektivat specifik silvikulturale**

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të këtyre punimeve silvikulturale synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke ndërthurur të gjithë komponentët së bashku: teknike, ekonomikë dhe sociale. Duke patur parasysh faktin qe diametri mesatar eshte i vogel, në grumbujt pyjor do të ndërhyhet me pastrime, rrallime paratregtare dhe tregtare, përgjatë 10 vjeçarit në vijim. Arsyet e këtyre ndërhyrjeve justifikohen me nevojat për të siguruar dru zjarri për banorët vendas dhe për të garantuar vijimësinë dhe qëndrueshmërinë e grumbujve të kësaj ekonomie. Objekti i prerjeve kulturore eshte, kujdesi per grumbullin dhe materiali drunor qe rezulton nga prerjet kulturore, perfaqeson deri ne 50 % te mases drunore te prodhuar ne një cikel prodhimi i cili mund te shkurtohet me 20-30 % ne kohe. Por çdo mase silvoteknike eshte racionale, kur efektet e saj pozitive jane me te medha dhe kur me ane te saj, arrihet ne kohen me te shkurter qellimi e caktuar Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit. Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në:

- pastrime për shpejtimin dhe drejtimin e procesit te eleminimit, duke nxjerrje ekzemplaret e pa deshirueshem,
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

Efektet e rrallimeve duhen pare njekohesisht ne prizmin e efekteve te tyre pozitive dhe negative (rrallimi ngadaleson krasitjen natyrore dhe perhapjen e barerave te keqia).

### **Objektivat specifik për kullotat**

Duhet të përmirësojmë ndjeshëm infrastrukturën në kullota veçanërisht në mbritshmëri dhe vepra ujëpirëse me qëllim rritjen e kapacitetit mbajtës dhe shmangjen ekullotjes së detyruar. Për të përmirësuar cilësinë e kullotave dhe për të zgjatur periudhën e kullotjes, konkretisht janë propozuar të ndërhyrjet me pastrim gurësh dhe shkurresh, pastrim barëra të këqija, ndërtim lerash, sistemim të rrugëve vëndeve të eroduara etj. Pastrimi i gurëve do të mundesojë rritjen e cilësisë së kullotës dhe biomasës së barit. Të shmanget mbikullotja që të mos paraqitet si problem, pasi kullotat shfrytëzohen me gjysmën e kapacitetit, përveç disa ngastra në afersi të zonave të banuara, për të cilat do të tregohet kujdes gjatë punimeve përmirësuese. Kur të jepen me qera kullotat numëri i bagëtive të jetë më i vogël se kapaciteti kullosoj kështu do të kemi kullota të shëndetëshme. Një objektiv mund të jetë zbatimi i rregullave teknike të kullotjes ku të aplikohen sipas rasteve kullotja: e lirë, me breza, me kunja, me shkop dhe racionale. Gjithashtu një kudesje të vecantë do të ketë për livadhët që kulloten dhe kositen duke bërë dhe kanale për kullimin e tyre në ato vënde ku lagështia është me e madhe.

### **Përfundime**

Në aspektin e organizimit natyror kjo ekonomi paraqet një ndërthurje të mirë të elemenetëve ekstensiv dhe intensive të burimeve dhe resurseve pyje, kullota, fond bujqësor, ujëra, florë, faunë dhe mbi të gjitha faktori njeri si përfitues, përdorues i ketyre burimeve. Gjithsesi, kërkohet një edukim i vazhdueshëm dhe menaxhimi afatgjatë e i qëndrueshem për ti vënë në funksion të përmirësimit të cilesisë së jetesës për komunitetet dhe grupet e interesit në zonë. Mund të themi se sipërfaqet pyjore dhe kullësore përbushin edhe funksione të tjera si; plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blektorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore përdorimi dhe përfthimi i të cilave duhet bërë nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve në mënyrë që të ofrojnë shërbimet e tyre për brezat e ardhshëm. Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare.

Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, fondi pyjor dhe kulloso qeveriset bazuar në **planet e mbarështimit** që përbëjnë dokumentet bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Bashkia Korçë duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e madhe që kanë sipërfaqet pyjore dhe kulloso si resurs natyror si edhe duke vlerësuar edhe detyrimin për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor dhe kulloso, që rrjedh nga legjislacioni i fushës, ka ndërmarrë nismën për të vijuar me procesin e miratimit të planeve të reja për 5 ekonomi pyjore dhe 1 kulloso, përkatesisht “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe “Rungajë”.

Pas realizimit planet e mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kulloso janë dorëzuar në Bashkinë Korçë.

Punimet e planeve të mbarështimit janë kryer në tre faza:

- Punime përgatitore
- Punime terreni
- Punime zyre

Planet e reja të mbarështimit të 5 ekonomive pyjore dhe 1 kulloso përcaktojnë hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë investimeve në fondin pyjor dhe kulloso nëpërmjet :

- a - pyllëzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara,
- b - shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve për nevojat publike,
- c - rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryerjet/erozioni,
- d - rritjen e prodhimit të lëndës drusore.

Nisur sa më sipër, referuar nenit 11, pika 2 shkronja “b” të ligjit 57/2020, “Për pyjet”, përcaktohet se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore si dokument bazë afat gjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, hartohen nga pronarët përkates sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore.

*Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkates.*

Në këto kushte, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e Pyjeve dhe Kullotave, *i propozon Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimarrës miratimin paraprak të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmblak – Qarr”, dhe ekonominë kullosore “Rungajë”.*

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj !

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike  
dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

**Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave**

Johan Marko

**KRYETARI I BASHKISË**

Sotiraq Filo